



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE - MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE - MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS - PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA - TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO

Përmbushja
vullnetare e
obligimeve

Shërbime
profesionale,
transparente dhe
efektive

Zbatim të
drejtë dhe të
njëlloshëm të
ligjeve tatimore

ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS

PLANI STRATEGJIK 2010 -2015

PRISHTINË 2010

ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS

**Plani
Strategjik
2010 - 2015**

PËRMBAJTJA

	<i>Faqe</i>
1 Përmbledhje ekzekutive	7
1.1 Parathënie e Drejtorit	7
1.2 Përmbledhje	9
2 Autorizimi dhe aprovimi	11
Miratimi	13
3 Përshkrimi organizativ	15
3.1 Përgjegjësitë	15
3.2 Historia jonë	15
3.3 Vizioni ynë	16
3.4 Vlerat tona	16
3.5 Misioni ynë	16
3.6 Ekipi i menaxhmentit të lartë	17
3.7 Struktura e ATK-së	19
Shtojcat	
a Qëllimet, veprimet dhe prioritetet 2010-2015.....	21
b Modeli i përmbushjes.....	42
c Projektioni i te hyrave sipas llojeve te tatimit.....	43
d Te dhënat e buxhetit.....	45
e Plani i veprimit të punës 2010	46
f Përshkrimi i procesit të zbatuar të planifikimit strategjik	47
g Procesi i monitorimit	48
h Indikatorët e matjes se performances.....	49

1.0 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 FJALA HYRËSE E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Viti 2010 shënon përvjetorin e 10-të të themelimit të Administratës Tatimore të Kosovës. Gjatë dhjetë viteve të ekzistencës së ATK-së, janë ndërmarrë hapa të mëdhenj për të përmirësuar kapacitetet dhe shërbimet tona ndaj publikut. Gjatë këtyre viteve bashkësia ndërkombëtare, në veçanti BE dhe USAID kanë ofruar mbështetje këshilluese dhe mbështetje përmes trajnimeve të cilat kanë ngritur në gjendjen e tanishme të zhvillimit, 10 vitet e kaluara kanë qenë sfidues, por sfida më e madhe na pret në të ardhmën.



Kemi një sistem të ligjeve tatimore të cilat i plotësojnë standardet ndërkombëtare dhe materializojnë parimet e BE-së. Ne kemi një bërthamë bazë të tatimpaguesve të rregullt të cilët paguajnë në mënyrë vullnetare pjesën më të madhe të tatimeve. Sfidat janë është t'i vetëdisojmë bizneset dhe individët për t'i kryer obligimet e tyre tatimore me kohe dhe sakte ne përputhje me ligjet ne fuqi. Sistemi ynë tatimor do të jetë më i efektshëm kur secili tatimpagues është pjesë e tij dhe kontribuon me pjesën e vetë të drejtë.

Përpjekjet tona gjatë periudhës së këtij Plani Strategjik fillimisht do të drejtohen në zgjerimin e bazës tatimore dhe mbledhjen e shumës së duhur të tatimit nga të gjithë tatimpaguesit. Këtë do ta bëjmë përmes rritjes së kapaciteteve tona teknike dhe shtimit të vëllimit të informatave për t'i vënë ne dispozicion për ATK-në që të sigurojë se secili është duke raportuar dhe paguar pjesën e vet të drejtë. Përveç kësaj, do të mundohemi të bëjmë punën tonë me integritet në mënyrë transparente, duke mos lënë dyshime për trajtimin e barabartë të tatimpaguesve. Përmes përpjekjeve dhe veprimeve tona, do t'i demonstrojmë publikut se jemi një organizatë publike që meriton besimin dhe respektin e tij. Ky është faktor kyç në përpjekjet tona për t'u bërë një Administratë Tatimore që i shërben gjithë popullit të Kosovës me integritet, efikasitet dhe drejtësi.

Behxhet Haliti

Drejtor i Përgjithshëm

Administrata Tatimore e Kosovës

1.2 PËRMBLEDHJE

Shteti ynë ka nevoje për të hyra me qëllim që të plotësojë përgjegjësitë për qytetarët dhe banorët e Kosovës për: rrugët, siguria, arsimit, spitalet, programet e mirëqenies sociale, etj. Të gjitha këto kërkojnë fonde. Misioni i Administratës Tatimore është të mbledhë të hyra që mundësojnë financim në mënyrë të drejtë dhe transparente. Varet nga tatimpaguesit që në mënyrë vullnetare të përcaktojnë detyrimin e tyre të saktë tatimor dhe të kryejnë me kohë pagesën e atij detyrimi.

Në zhvillimin e Planit Strategjik, po ashtu kemi zhvilluar një strategji të përmbushjes që do t'i drejtojë përpjekjet tona të përmbushjes përmes rrugës së këtij Plani Strategjik. Si rezultat, Plani jonë Strategjik dallon nga planet e mëhershme, të cilat kanë qenë të përqendruara në këto fusha kryesore: Klientët, Organizatën, Sistemet dhe Personelin. Ky plan strategjik do të përqendrohet në 12 komponentë kryesore të cilat do të ndihmojnë ATK-në të arrijë qëllimet e veta të përmbushjes dhe të hyrave, përderisa në të njëjtën kohë do të sigurojë se sistemet tona janë të freskuara, personeli është i trajnuar mirë, ligjet janë aplikuar me efektivitet dhe stafi e kryen punën e vet me integritet dhe drejt. Komponentët janë të bazuara në parimin se ekzistojnë katër kategori të tatimpaguesve, ata të cilët kanë gatishmërinë ta bëjnë gjënë e duhur me kohë duke dorëzuar deklaratat e tyre dhe duke paguar detyrimin e tyre të saktë tatimor; ata të cilët mundohen të bëjnë gjënë e duhur, por nuk kanë sukses gjithnjë; ata të cilët nuk duan të përmbushin detyrimet; dhe ata të cilët kanë vendosur të mos i përmbushin detyrimet. Përpjekjet tona të përmbushjes do t'i përqendrojmë në strategjitë që janë të nevojshme për të adresuar secilën prej këtyre katër grupeve të tatimpaguesve. Ato do të radhiten nga edukimi i tatimpaguesit deri të ndjekjet penale.

Gjatë këtij Plani Strategjik, do ta bëjmë të lehtë përmbushjen duke implementuar deklarin elektronik për të gjithë tatimpaguesit. Gjithashtu do të themelojmë një Qendër të thirrjeve, ku tatimpaguesit mund të thërrasin falas për të marrë informatat që u duhen lidhur me dorëzimin e deklaratës së tyre dhe obligimet e pagesës. Me qëllim që të sigurohet se tatimpaguesit të dinë si të përmbushin obligimet, do të përgatiten pamflete me informata në tema të llojllojshme dhe do të zhvillohen fushata mediale për të ndihmuar që opinioni është në dijeni dhe i kupton obligimet e veta tatimore.

Kohëve të fundit Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligjet e reja mbi Tatimin në të Ardhurat Personale, Tatimin në të Ardhurat e Korporatave dhe TVSH-në. Të gjitha këto ligje do të kërkojnë material të edukimit të tatimpaguesve, udhëzime të reja administrative dhe udhëzime të reja të brendshme. Ato gjithashtu do të kërkojnë komunikim më të mirë me tatimpaguesit dhe këshilltarët tatimor. Duke përdorë një kombinim të seminareve dhe fushatave publike, do të përpiqemi të edukojmë të gjithë tatimpaguesit për të drejtat dhe obligimet e tyre.

Në të njëjtën kohë, do të rrisim kapacitetet tona duke zbatuar ligjet tatimore në lidhje

me ata të cilët nuk raportojnë me saktësi transaksionet e tyre përmes rritjes së vëllimit të informatave në dispozicion për administratën tatimore nga burime shtetërore si dhe nga burime tjera. Inspektorët tatimorë do të trajnohen mbi ligjet e reja dhe mbi procedurat e mira të kontrollit. Rastet tona të përzgjedhura për kontroll do të bëhen përmes një sistemi të përzgjedhjes i bazuar në rrezik që do të sigurojë drejtësi dhe objektivitet në proces. Kjo po ashtu do të na mundësojë që burimet tona t'i përqendrojmë në ata tatimpagues të cilët kanë probabilitetin më të madh të raportimit jo të rregullt të detyrimeve të tyre tatimore. Do të themelohet një njësi e hetimeve tatimore e cila do të jetë përgjegjëse për hetimin e mashtrimit tatimor dhe do të punojë me prokurorët që t'i sjellë rastet e mashtrimit tatimor para gjyqit.

Ligji mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, i ndryshuar, parasheh autorizime shtesë për stafin tonë të mbledhjes së detyrueshme. Janë nxjerrë rregulloret implementuese në lidhje me ato autorizime të reja. Gjatë afatit të këtij plani strategjik, do të trajnojmë stafin dhe do të përgatisim udhëzimet e brendshme dhe formularët ashtu që të mund të shfrytëzohen në tërësi të gjitha autorizimet të reja.

Sistemi ynë i përpunimit të të dhënave të Administratës Tatimore, SIGTAS, do të përtërihet në pjesën e parë të këtij Plani Strategjik. Kjo do të mundësojë përmirësime në mundësitë e procesimit dhe menaxhimit të punës së kontrollit dhe mbledhjes së tatimeve. Baza e të dhënave të tatimpaguesit nuk na ka lejuar që në mënyrë të përshtatshme të monitorojmë përmbushjen e tatimpaguesve. Me implementimin e numrave fiskal, kemi një mundësi që të vendosim një bazë të të dhënave të besueshme, që do të jetë një përqendrim në vitet e para të planit tonë strategjik. Me përmirësimin e vlefshmërisë së bazës sonë të të dhënave për tatimpaguesit, po ashtu do të kemi mundësinë të përmirësojmë besueshmërinë e informatave në sistemin tonë lidhur me tatimet e papaguara dhe deklaratat të cilat nuk janë dorëzuar. Një bazë e besueshme e të dhënave është me rëndësi për përpjekjet tona në uljen e numrit të mos-deklaruesve dhe ndalim-deklaruesve që negativisht ndikojnë në të hyrat tona dhe në sistemin tonë të përmbushjes vullnetare.

Kur ky Plan Strategjik të jetë zhvilluar, ne do të bëjmë ndryshime në strukturën organizative të Administratës Tatimore. Ato ndryshime do të vazhdojnë deri sa të vendosim një strukturë që do të përmirësojë efektivitetin tonë menaxherial dhe mundësinë e mbikëqyrjes. Ato gjithashtu do të sigurojnë se mundësia jonë për anti-korrupsion është përforcuar.

Sikurse që cekët në vizionin tonë, qëllimi ynë është të bëhemi të parët në vjeljen e të hyrave për shtetin. Ne duhet të vjelim të hyra në një mënyrë që nuk vështirëson rritjen ekonomike, përderisa të sigurohet se të gjithë tatimpaguesit ndajnë të njëjtën barrë të pagesës së tatimeve në përputhje me dispozitat e ligjit. Ne besojmë se ky plan strategjik do të na çojë drejt arritjes së misionit dhe vizionit tonë. Ne shpresojmë të përparojmë në pesë vitet e ardhshme që do të vijnë.

2.0 AUTORIZIMI

KONTRIBUES:

Behxhet Haliti, Drejtor i Pëgjithshëm i ATK-së

Bashkim Shala, Zëvendës Drejtor Puna në teren

Sakip Imeri, Zëvendës Drejtor Përmbushje

Hamit Mulaj, u.d. Zëvendës Drejtor Shërbime të Përbashkëta

Rifat Hyseni, Zëvendës Drejtor Teknologjia Informative

Nahit Sharku, Drejtor për Modernizim dhe Planifikim Strategjik

Ekrem Hysenaj, Drejtor për Zyrën Ligjore dhe Ankesa

Menaxherët Regjional:

Ilir Murtezaj, NjTM

Nikson Mirdita, Prishtina 1

Isen Lipovica, Prishtina 2

Besim Ahmetaj, Peje

Ramadan Kryeziu, Prizren

Ukshin Rrecaj, Mitrovice

Fikret Ibrahimimi, Ferizaj

Valdet Bektashi, Gjilan

Lazër Ramaja, Gjakove

Menaxherët e Zyrës Qendrore:

Tefik Ujkani, Planifikimi dhe Analiza

Ilir Islami, Personeli

Shyhrete Gllogu, Zyra Ligjore

Melihate Godanci, Auditimi i Brendshëm

Arsim Sylja, Standardet Profesionale

Teuta Morina, Ankesat

MIRATIMI PËRFUNDIMTAR:


Aprovim:



Data: 30/06/2010

Behxhet Haliti, Drejtor i Përgjithshëm i ATK-së


Aprovim:



Data: 30/06/2010

Bashkim Shala, Zëvendës Drejtor – Puna në teren


Aprovim:



Data: 30/06/2010

Sakip Imeri, Zëvendës Drejtor – Përbushje


Aprovim:



Data: 30/06/2010

Hamit Mulaj, u.d. Zëvendës Drejtor – Shërbime të Përbashkëta


Aprovim:



Data: 30/06/2010

Rifat Hyseni, Zëvendës Drejtor – Teknologjia Informativ


Aprovim:



Data: 30/06/2010

Nahit Sharku, Drejtor për Modernizim dhe Planifikim Strategjik

Aprovim:



Data: 30/06/2010

Ekrem Hysenaj, Drejtor për Zyrën Ligjore dhe Ankesa

3.0 PËRSHKRIMI ORGANIZATIV

3.1 PËRGJEGJËSITË TONA

Ne jemi përgjegjës për inkasimin e tatimeve qendrore qeveritare ku bëjnë pjesë TVSH në furnizimet e brendshme, Tatimi në të Ardhurat e Korporatave, Tatimi në të Ardhurat Personale, tatime tjera të mbajtura në burim dhe Kontributet Pensionale. Përveç kësaj jemi përgjegjës edhe për dhënien e licencave për lojërat e fatit, mbikëqyrjen e përmbushjes së obligimeve nga aktivitetet e lojërave të fatit dhe zbatimin e Ligjit për Lojërat e Fatit.

3.2 HISTORIA JONË

ATK është themeluar me datën 17 Janar 2000 nën drejtimin dhe administrimin e UNMIK-ut. Drejtor i parë i ATK-së ishte ndërkombëtar i punësuar nga një kontraktues i USAID-it. Nga Tetori i vitit 2001 deri në Shkurt të vitit 2003, kishte bashkë-drejtorë nga USAID-i dhe vendor që ndanin rolin e drejtorit. Me 18 Shkurt 2003, autoriteti për Administratën Tatimore u bart nga UNMIK-u te Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe mori detyrat e Drejtorit të ATK-së një vendor. Që nga ajo kohë, ATK ka funksionuar si një organizatë autonome, e menaxhuar krejtësisht nga banorë të Kosovës me këshillime dhe ndihmën e organizatave donatore ndërkombëtare në radhë të parë, USAID-i, BE dhe FMN.

Gjatë historikut të shkurtër të saj, ATK ka zhvilluar një strukturë organizative funksionale e cila në pjesën më të madhe të saj është në pajtim me praktikat më të mira ndërkombëtare. Ka një qendër përpunimi të dokumenteve, të centralizuar, përmes së cilës përpunohen të gjitha deklaratat, po ashtu ka filluar decentralizimi i procedimit të TVSH-se me qëllim të intervenimit të përmbushjes së menjëhershme. Është krijuar edhe një Njësi për tatimpaguesit e mëdhenj që merret me tatimpaguesit më të mëdhenj në Kosovë, që njëherit është praktika më e mirë ndërkombëtare. Legjislacioni tatimor i Kosovës është pranuar si nga FMN-ja ashtu edhe nga Komisioni Evropian si legjislacion transparent dhe në harmoni me standardet ndërkombëtare.

Me gjithë zhvillimin e vet dhe asistencën e dhënë, ATK ende duhet shumë për të bërë që të jete Administratë Tatimore moderne, eficiente dhe një organizatë prijëse

3.2 VIZIONI YNË ËSHTË QË ADMINISTRATA TATIMORE:

- të formojë dhe ta ruaj një imazh pozitiv për të mirën e shtetit të Kosovës,
- të respektohet nga klientët tanë dhe të njihet nga organizatat dhe institucionet ndërkombëtare,
- të përbëhet nga personeli profesionist dhe energjik që do të garantojnë një nivel të lartë të transparencës dhe modernizimin e shërbimeve tona në raport me klientët tanë, përmes të cilës ne do të bëhemi burimi kryesor i të hyrave për shtetin e Kosovën.

3.4 SUKSESI YNË VARET KUR TË GJITHË NE MARRIM PJESË NË NDARJEN E VLERAVE TË NJËJTA.

Administrata Tatimore do të ec përpara falë këtyre vlerave gjatë tërë punës sonë:

- **Integriteti** dhe sinqeriteti do të jenë gurë themeli i institucionit tonë, që sigurojnë një trajtim të barabartë ndaj tatimpaguesve dhe zbatim të drejtë të ligjeve,
- **Profesionalizmi** do të jetë çelësi i suksesit në përmbushjen e misionit tonë, duke synuar në përmirësime të vazhdueshme drejt standardeve më të larta të suksesit,
- **Transparenca** do të jetë elementi kyç për ndërtimin e lidhjeve të forta me tatimpaguesit dhe të besimit në Administratën Tatimore,
- **Respekti** ndaj tatimpaguesve dëshmohet përmes kontakteve tona në të cilat ne i pranojmë të drejtat e tyre dhe obligimet tona,
- **Fleksibiliteti** do të jetë bazë për zhvillimet e reja në organizatën tonë

3.5 MISIONI YNË ËSHTË:

- të shtohet në maksimum përmbushja vullnetare e obligimeve, duke i dhënë përqendrim të plotë legjislacionit dhe rregulloreve tatimore;
- të ofrojmë shërbime profesionale, transparente dhe efektive për komunitetin e tatimpaguesve në mënyrë që ata të kuptojnë obligimet e tyre të pagesës së tatimeve; dhe
- të sigurojmë zbatim të drejtë dhe të njëllojshëm si dhe fuqizimin e ligjeve tatimore me qëllim që të mblidhen të hyra për buxhetin e Kosovës në një mënyrë efikase dhe me kosto të ultë.

3.6 EKIPI I MENAXHMENTIT TË LARTË TË ATK-SË

Behxhet Haliti, Drejtor i Përgjithshëm i ATK-së

Bashkim Shala, Zëvendës Drejtor Puna ne teren

Sakip Imeri, Zëvendës Drejtor Përmbushje


Hamit Mulaj, Zëvendës Drejtor Shërbimet e Përbashkëta

Rifat Hyseni, Zëvendës Drejtor Teknologjia Informative

Nahit Sharku, Drejtor për Modernizim dhe Planifikim Strategjik

Ekrem Hysenaj, Drejtor për Zyrën Ligjore dhe Ankesa

3.7 STRUKTURA ORGANIZATIVE E ATK-SË



STRATEGJIA E PËRMBUSHJES - KOMPONENTAT DHE VEPRIMET

1. MISHËRIMI ME OBLIGIMET E PËRCAKTUARA NËPËRMES STATUTIT (KARTËS) TË TATIMPAGUESVE				
OBJEKTIVI	VEPRIMI	PËRGJEGJËS	FILLON	MBARON
<p>Populli i Kosovës meriton një Administratë Tatimore që do të zbatoj ligjet tatimore në një mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme që plotëson obligimet tona sipas statutit tonë të tatimpaguesit. Ne do t'i kryejmë veprimtaritë tona të përditshme në atë mënyrë që publiku të pranojë profesionalizimin tonë dhe të zhvillojë besim në institucionin tonë, sikurse është paraparë në Kodin tonë Profesional të Mirësjelljes. Një Administratë Tatimore e respektuar do të krijojë një nivel të caktuar të përmbushjes vullnetare thjesht duke pranuar publiku se ajo është duke i plotësuar obligimet e veta në një rrugë profesionale dhe të drejtë. Përmes strategjisë sonë, do të: Zgjerojmë bazën tatimore duke përfutur besimin e publikut në Ne si një institucion kyç i shtetit; Zbatojnë Kodin e Mirësjelljes së ATK -së në lidhje me punëtorët tanë, njësoj ti zbatojmë ligjet tatimore kundër atyre që nuk përmbushin ligjet tatimore; Ri-organizojë administratën tonë tatimore me qëllim që të përmirësohen kapacitetet tona të administrimit të sistemit në mënyrë të drejtë dhe objektive; Vendosë ekip të avokatit tatimor për të dëgjuar ankimet e tatimpaguesve të cilët besojnë se ATK nuk ka respektuar të drejtat e tatimpaguesit, ka bërë gabim në proceset e saja, nuk e ka trajtuar tatimpaguesin si duhet, apo për të marrë përgjigjet në Anketën e Pëlqimit të Palës që lidhet me kontrollin dhe mbledhjen e detyrueshme.</p>	1.1 Çdo vjet, te prezantohet trajnimi për kodin e Mirësjelljes për të gjithë punëtorët e ATK -së,	Menaxheri, Zyra e Standardeve Profesionale	Korrik 2010	Vazhdon
	1.2 Të hetohen të gjitha pohimet për sjellje të keqe nga punëtorët e ATK -së, duke siguruar se të gjitha konfliktet e interesit janë hequr.	Menaxheri, Zyra e Standardeve Profesionale	Korrik 2010	Vazhdon
	1.3 Të sigurohet transparencë të Administratës Tatimore duke publikuar të gjitha vendimet shpjeguese publike dhe udhëzimet administrative ashtu që publiku të jetë në dijeni për të gjitha dokumentet e lëshuara që ndikojnë në mundësinë e tyre për të përmbushur ligjet tatimore.	Menaxheri, Edukimi i Tatimpaguesve	Korrik 2010	Vazhdon
	1.4 Vendosja e stafit të avokatit për tatimpaguesit për të marrë parasysh ankimet e tyre dhe Zhvillimi i procedurave që duhet ndjekur në pranimin dhe përpunimin e ankimeve,	Menaxheri, Avokati i Tatimpaguesit	Shtator 2010	Qershor 2011
	1.5 Te edukohet publiku mbi gatishmërinë dhe përgjegjësinë e avokatit të tatimpaguesit dhe si të dorëzohen ankimet.	Menaxheri, Avokati i Tatimpaguesit	Shtator 2010	Qershor 2011
	1.6 Te sigurohet transparencë të aktiviteteve të Administratës Tatimore duke ofruar një llogari vjetore për publikun për rezultatet e punës, duke i përfshirë veprimet e ndërmarra.	Drejtori i Përgjithshëm	Në janar të çdo viti. Raporti i pare për aktivitete të zhvilluara, nga janari 2011	Vazhdon
	1.7 Të rishikohet struktura e tanishme organizative dhe ndryshoje nëse është e nevojshme.	Drejtori i Përgjithshëm	Korrik 2010	Dhjetor 2010

2. SIGURIMI I INTEGRITETIT TË BAZËS SË TË DHËNAVE

OBJEKTIVI	VEPRIMI	PËRGJEGJËS	FILLON	MBARON
<p>Një bazë e besueshme e të dhënave për tatimpaguesit është kërkesë thelbësore për çdo administratë tatimore. Në vitin 2009, ATK ka implementuar një kërkesë që secili tatimpagues të marrë një numër fiskal</p> <p>nga administrata tatimore përpara se ndonjë biznes të fillojë një veprimtari ekonomike. Ndëshkimet janë paraparë për ato biznese që nuk marrin numra fiskal siç kërkohet. Ne do të përdorim burime të ndryshme për të zhvilluar dhe mbrojtur bazën e të dhënave të tatimpaguesve.</p>	<p>2.1 Të vazhdohet fushata mediale për te siguruar se të gjitha bizneset e reja janë në dijeni për kërkesën për të marrë numër fiskal nga ATK para se të angazhohen në veprimtari ekonomike.</p>	<p>Zëvendës Drejtori (Përbushja) Menaxheri, Edukimi i Tatimpagues ve</p>	<p>Korrik 2010</p>	<p>Vazhdon</p>
	<p>2.2 Të organizohen seminare në bashkëpunim me SHKÇAK për kontabilitet dhe grupet tjera praktikuese të tatimeve për të siguruar se janë në dijeni për kërkesat për numra fiskal.</p>	<p>Zëvendës Drejtori (Përbushja) Menaxheri, Edukimi i Tatimpagues ve</p>	<p>Tetor 2010, dhe tutje çdo tremujor</p>	<p>Qershor 2011</p>
	<p>2.3 Inspektoret e Edukimit të Tatimpaguesve vizitonjnë të gjitha bizneset e reja për të edukuar tatimpaguesit në deklarimin dhe pagimin e obligimeve dhe për të konfirmuar ekzistencën e biznesit.</p>	<p>Menaxherët Regional</p>	<p>Korrik 2010</p>	<p>Vazhdon</p>
	<p>2.4 Të përputhen informatat nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve me tatimpaguesit e regjistruar në regjistrin e ATK - së – vizitoni të gjitha bizneset që nuk përputhen për të konfirmuar nëse ato janë aktive apo pasive; kërkoni çregjistrimin e të gjitha bizneseve pasive.</p>	<p>Menaxheri, Edukimi i Tatimpagues ve; Menaxherët Regional</p>	<p>Korrik 2010</p>	<p>Vazhdon</p>
	<p>2.5 Publikimi i emrave e të gjitha bizneseve pasive ashtu që bizneset të jenë në dijeni për bizneset që nuk janë aktive dhe pasojat nëse bëhet afarizëm me ato biznese.</p>	<p>Menaxheri, Edukimi i Tatimpagues ve</p>	<p>Vazhdon nga 2009</p>	<p>Vazhdon</p>
	<p>2.6 Fushata mediale për të informuar të gjitha bizneset për qasjen në informatat në ATK për të përcaktuar nëse një tatimpagues është aktiv, apo jo, ashtu që publiku të jetë i informuar se si të përcaktojë nëse një biznes është aktiv apo jo.</p>	<p>Menaxheri, Edukimi i Tatimpagues ve</p>	<p>Qershor 2010 Qershor 2011</p>	<p>Shtator 2010 Shtator 2011</p>
	<p>2.7 Zyrat regjionale të kontaktojnë me të gjitha bizneset pa numër fiskal në bazën e të dhënave të SIGTAS-it që më herët nuk janë transferuar në gjendjen pasive për të konfirmuar nëse janë aktive apo pasive dhe për të ndërmarrë veprime të duhura për të siguruar deklaratat e pa dorëzuara, për të mbledhur tatimet e papaguara, apo për t'i transferuar në gjendjen pasive.</p>	<p>Menaxherët Regional</p>	<p>Korrik 2010</p>	<p>Tetor 2010</p>

	2.8 Mbledhja e Detyrueshme të kontaktoj me mostër të bizneseve në bazën e vjetër të të dhënave të SIGTAS-it të ATK -së për të konfirmuar se a janë pasive apo aktive dhe për të ndërmarrë veprime të duhura për të siguruar deklaratat e pa dorëzuara, për të mbledhur tatimet e papaguara, apo për t'i transferuar në gjendjen pasive.	Menaxherët Regjional	Shtator 2010	Janar 2011
	2.9 Të organizohen fushata të përmbushjes, duke përfshirë takime derë më derë, për të identifikuar tatimpaguesit e paregjistruar.	Zëvendës Drejtori (Përmbushja) Zëvendës Drejtori (TI)	Korrik 2010	Së paku në vit dhe siç identifikohet e nevojshme
	2.10 Të krahasohen informatat nga organizatat tjera shtetërore (kadastra, regjistrimi i automjeteve, etj.) për të identifikuar individët dhe bizneset që nuk janë regjistruar në administratën tatimore, por që është dashur.	Zëvendës Drejtori (Përmbushja) Zëvendës Drejtori (TI)	Janar 2011	Vazhdon
	2.11 Identifikimi i burimeve tjera për përputhje të informatave për qëllimi regjistrimi.	Zëvendës Drejtori (Përmbushja) Zëvendës Drejtori (TI)	Korrik 2011	Vazhdon
	2.12 Te harmonizohen informatat nga komunat për të siguruar se të gjitha bizneset e licencuara nga komuna janë regjistruar në administratën tatimore; vendosni procesin e përputhjes automatike ashtu që mospërputhjet të paraqiten automatikisht për zyrën e aplikueshme regjionale.	Zëvendës Drejtori (Përmbushja) Zëvendës Drejtori (TI) Nëse një projekt është përcaktuar i nevojshëm për dizajn dhe implementim, përgjegjësia do t'i transferohet Drejtorit për Modernizim.	Shtator 2010	Qershor 2011

3. PUNA ME PUBLIKUN PËR EDUKIMIN E VAZHDUESHËM RRETH KRYERJES SE OBLIGIMEVE TATIMORE

OBJEKTIVI	VEPRIMI	PËRGJEGJËS	FILLON	MBARON
<p>Pjesa dërrmuese e tatimpaguesve dëshirojnë të përmbushin ligjet tatimore me qëllim që të sigurojnë funksionim më të efektshëm të shtetit, dhe mundësia që shteti të plotësojë nevojat sociale për publikun. Dëshirojmë të sigurojmë se ata i kanë të gjitha informatat që u duhen me qëllim që të përmbushin shumën e vogël të ngarkesës tatimore.</p> <p>Përpjekjet tona do të jenë për të shtuar sa më shumë informatat në dispozicion për publikun përmes broshurave dhe pamfleteve ashtu që ata të dinë obligimet e tyre dhe si t'i kryejnë ato. Ne do të zhvillojmë faqen tonë të internetit ashtu që të përmbajë informatat e nevojshme, që publiku lehtë të mund të gjejë çka i duhet dhe qasja të jetë më e thjeshtë deri në masën e mundshme. Ne do të mbajmë seminare dhe aktivitete shume - përfshirëse për tatimpagues specifik dhe audiencë të caktuar për të shtuar efektivitetin e përpjekjeve tona.</p>	3.1 Përgatitja e pamfletit sqarues për TVSh-në	Menaxheri, Edukimi i Tatimpaguesve Menaxheri, Kontrolli	Korrik 2010	Gusht 2010
	3.2 Ndryshimi i formularit të TVSh-së në përputhje me ligjin e ri të TVSh -së	Menaxheri, Edukimi i Tatimpaguesve	Qershor 2010	Korrik 2010
	3.3 Dizajnimi dhe implementimi ne përmbledhjen e pasqyrës financiare për ta bashkëngjitur në Deklaratat e Tatimit në të Ardhurat e Korporatave dhe Personale si një tabelë e ndarë për deklaratat e vitit 2009 – informatat të përdoren në Modelin e Kontrollit.	Menaxheri, Edukimi i Tatimpaguesve Menaxheri, Kontrolli	Tetor 2010	Nëntor 2010
	3.4 Te përgatitet një seri të Pyetjeve më të shpeshta dhe përgjigjeve për to, për publikun në faqen e internetit të ATK -së – përfshij në pamflete të ndryshme aq sa është e mundur.	Menaxheri, Edukimi i Tatimpaguesve Tatimin ne TAP Tatimin në TAK TVSh	Korrik 2010 Korrik 2010 Korrik 2010	Shtator 2010 Shtator 2010 Shtator 2010
	3.5 Përgaditja e pamfletit për Tatimin në të Ardhurat Personale	Menaxheri, Edukimi i Tatimpaguesve Menaxheri, Kontrolli	Korrik 2010	Shtator 2010
	3.6 Ndryshimi i formularit të Tatimit në të Ardhurat Personale në përputhje me ligjin e re mbi Tatimin në të Ardhurat Personale.	Menaxheri, Edukimi i Tatimpaguesve	Korrik 2010	Shtator 2010
	3.7 Përgaditja e pamfletit Sqarues për Ligjin e Tatimit në të Ardhura ne Korporata	Menaxheri, Edukimi i Tatimpaguesve Menaxheri, Kontrolli	Korrik 2010	Shtator 2010
	3.8 Ndryshimi i formularit të Tatimit në të Ardhurat e korporatave në përputhje me Ligjin e ri të Tatimit në të Ardhurat e Korporatave.	Menaxheri, Edukimi i Tatimpaguesve	Korrik 2010	Korrik 2010
	3.9 Përgaditja e akteve nënligjore për implementimin e ligjeve të reja; TVSh, Tatimit në të Ardhurat e Korporatave dhe Tatimit në të Ardhurat personale	Zëvendës Drejtori (Përmbushja) Tatimet në të Ardhura TVSh	Korrik 2010 Korrik 2010 Korrik 2010	Shtator 2010 Shtator 2010 Korrik 2010

	3.10 Identifikimi i gabimeve të zakonshme në deklarata dhe ofrimi i informatave si të shmangen ato.	Menaxheri, Edukimi i Tatimpaguesve.	Shkurt 2011 Vjetor.	Shkurt 2011 Vjetor.
	3.11 Identifikimi i shkaqeve më të zakonshme të ndëshkimeve e rregullimeve tatimore dhe ofrimi i Informatave si të raportohen ato me saktësi ashtu që ndëshkimet dhe rregullimet të mund të shmangen – Përfshij në raportin vjetor të Drejtorit të Përgjithshëm për publikun.	Menaxheri, Kontrolli	Tetor 2010 Tetor 2011 Vjetor	Dhjetor 2010 Dhjetor 2011 Vjetor
	3.12 Publikimi i të gjitha ligjeve tatimore, udhëzimeve administrative, vendimeve shpjeguese publike, formularët tatimor dhe materialet edukative në faqen e internetit të administratës tatimore,	Menaxheri, Edukimi i Tatimpaguesve	Korrik 2010	Vazhdon
	3.13 Ndryshimi i formatit të faqes së internetit për të përmirësuar qasjen e publikut dhe përdorimin më të lehtë	Menaxheri, Edukimi i Tatimpaguesve	Shkurt 2011	Maj 2011
	3.14 Te mbahen seminare publike për të gjitha ligjet e reja tatimore dhe procedurat që lidhen me to në bashkëpunim me organizatat e ndryshme afariste, SHKÇAK, etj.	Zëvendës Drejtori (Përbushja)	Shtator 2010	Dhjetor 2010
	3.15 Të organizohen tryeza të rumbullakëta dhe seminare informuese në zyrat regjionale çdo tremujor për të gjitha bizneset e interesuara – të shënjuara për segmente specifike të tatimpaguesve.	Menaxherët Regjional	Tetor 2010	Tremujor e deri më 2015
	3.16 Te mbahen konsultime me SHKÇAK dhe organizatat afariste për të përcaktuar nevojat e ndryshme të llojeve të ndryshme të bizneseve dhe zhvillo seminare të shënjuara informative dhe informata me shkrim.	Zëvendës Drejtori (Përbushja)	Shkurt 2011	Qershor 2011

4. PËRMIRËSIMI I KAPACITETEVE TEKNIKE TE STAFIT TË EDUKIMIT TË TATIMPAGUESVE DHE SHFRYTËZIMI I METODAVE TË REJA PËR OFRIMIN E INFORMATAVE PËR PUBLIKUN

OBJEKTIVI	VEPRIMI	PËRGJEGJËS	FILLON	MBARON
Me zhvillimin e sistemit tonë tatimor dhe me rritjen e numrit të tatimpaguesve, kërkesat tek stafi i administratës tatimore do të shtohen. Në rritjen e numrit, tatimpaguesit do të duhet të marrin informatat e pasakta dhe ndihmën e personelit nga stafi i administratës tatimore. Me qëllim që të plotësohen ato kërkesa, ne do të ofrojmë trajnimin shtesë për stafin tonë të Edukimit të Tatimpaguesve për të siguruar se ata kanë njohuritë për të qenë në gjendje për t'iu përgjigjur pyetjeve të publikut. Po ashtu do të shtojmë mënyrat me të cilat tatimpaguesit mund të kontaktojnë administratën tatimore për ndihmë.	4.1 Të trajnohet i gjithë stafi i Edukimit të Tatimpaguesve për ligjet dhe procedurat ekzistuese.	Zëvendës Drejtori (Operacionet)	Shtator 2010	Dhjetor 2010
	4.2 Vendosija e programit të Edukimit të Vazhdueshëm për të siguruar se stafi i Edukimit të Tatimpaguesve mbetet aktual në procedura dhe ligje.	Zëvendës Drejtori (Përmbushja)	Janar 2011	Mars 2011
	4.3 Te organizohen trajnime Profesionale te vazhdueshme për stafin e Edukimit të Tatimpaguesve.	Menaxheri, Trajnimet	Prill 2011	Së paku vjetor
	4.4 Të shfrytëzohet personeli i Edukimit të Tatimpaguesve për mbajtjen e seminarëve gjithë-përfshirëse dhe takimeve punuese.	Menaxherët Regjional	Tetor 2010	Vazhdon
	4.5 Vendosija e portalit për qasje nga tatimpaguesit që do t'i mundësojë tatimpaguesve një lexim të llogarive të veta dhe të dhëna tjera që do t'i ndihmojnë ata në përmbushje të ligjeve tatimore.	Drejtori i Modernizimit Zëvendës Drejtori (TI)	Shkurt 2011	Korrik 2011
	4.6 Të vendoset një Qendër E thirrjeve me shpërndarje moderne të thirrjeve dhe mundësi të përgjigjeve automatike për kontaktet e tatimpaguesve përmes së cilave tatimpaguesit mund të pranojnë ndihmën telefonike përmes një linje telefonike falas,	Drejtori i Modernizimit	Qershor 2011	Shkurt 2012
	4.7 Te pajiset Qendra e thirrjeve me mundësi moderne për qasje për informatat e tatimpaguesit, pyetjet më të shpeshta, materialet e kërkimeve elektronike, etj.	Drejtori i Modernizimit	Qershor 2011	Shkurt 2012

5. VENDOSJA E PROCESIVE QË DO TË NDIHMOJNË PARASHTRIMIN DHE PËRPUNIMIN ME KOHË TË DEKLARATAVE DHE PAGESAVE

OBJEKTIVI	VEPRIMI	PËRGJEGJËS	FILLON	MBARON
<p>Administrata tatimore do të bëjë çdo përpjekje për të ndihmuar parashtrimin e deklaratave dhe pagesave të tatimeve. Përpunimi me vonesë i deklaratave ndikon negativisht në saktësinë e bazës sonë të të dhënave dhe rezultateve në deklarime të pasakta, përveç shtimit të barrës në tatimpagues kur ata të përpiqen të marrin certifikatat për tenderë, etj. Aplikimi me vonesë i pagesave shkakton njoftime të panevojshme për tatimpaguesin dhe raportim të pasaktë të të hyrave.</p> <p>Ne e kuptojmë që për ta bërë më të lehtë për të gjithë tatimpaguesit për të parashtruar deklaratat e tyre dhe pagesa e tatimeve të tyre do të përmirësojë shkallën e përmirësimit të vullnetare. Ne do të ofrojmë mundësi tjera për tatimpaguesit për të dorëzuar deklaratat. Ne do të rrisim praninë e formularëve të cilët mund të shkarkohen nga sistemi ynë me emër, adresë dhe informata tjera identifikuese të para shtypura. Ne do të fillojmë deklarimin elektronik fillimisht për një numër të kufizuar të formularëve dhe mandej do ta zgjerojmë këtë për të përfshirë të gjitha deklaratat e parashtruara në administratën tatimore. Ne do të përmirësojmë përpunimin e pagesave ashtu që pagesat do të vendosen drejtpërdrejtë në llogaritë e tatimpaguesit dhe do të rrisin saktësinë e të dhënave në administratën tatimore, kështu që si tatimpaguesit ashtu edhe zyrtarët tatimor të mund të mbështeten në saktësinë e informatave të ofruara nga sistemi i ATK -së.</p>	5.1 Kryerja e një rishikimi të plotë të përpunimit të deklaratave për të identifikuar çështjet dhe pengesat e përpunimit me kohë të deklaratave.	Zëvendës Drejtori (Përmirësues)	Korrik 2010	Tetor 2010
	5.2 Implementimi i rekomandimeve për përmirësim.	Zëvendës Drejtori (Përmirësues) Zëvendës Drejtori (Operacionet)	Shtator 2010	Qershor 2011
	5.3 Identifikimi i gabimeve më të zakonshme dhe përcaktimi i Mënyrave më të duhura të eliminimit të atyre gabimeve në të ardhmen.	Zëvendës Drejtori (Përmirësues)	Shtator 2010	Prill 2011
	5.4 Zgjerimi për përdorimin e deklaratave të para shtypura të shkarkuara nga faqja e internetit të ATK -së	Zëvendës Drejtori (TI) Menaxheri, Edukimi i Tatimpaguesve	Korrik 2010	Dhjetor 2010
	5.5 Implementimi i deklarimit elektronik për të gjitha llojet e tatimeve dhe raportet e shumë palëve të treta	Drejtori, Modernizimi Zëvendës Drejtori (TI) Menaxheri, Edukimi i Tatimpaguesve	Shtator 2010	Gusht 2010
	5.6 Implementimi në procesin e ndryshuar të pagesave në përputhje me Bankën Qendrore.	Zëvendës Drejtori (TI)	Korrik 2010	Nëntor 2010
	5.7 Kryerja e studimeve për të përcaktuar fizibilitetin e përpunimit të decentralizuar të deklaratave të caktuara dhe Dorëzimi i rekomandimit Drejtorit të Përgjithshëm	Zëvendës Drejtori (Përmirësues) Zëvendës Drejtori (TI)	Korrik 2010	Shtator 2010
	5.8 Hulumtimi i metodave tjera të pranimit të pagesave.	Zëvendës Drejtori (Përmirësues) Zëvendës Drejtori (TI)	Mars 2012	Shtator 2012

6. PARANDALIMI DHE INTERVENIMI I HERSHËM.

OBJEKTIVI	VEPRIMI	PËRGJEGJËS	FILLON	MBARON
<p>Sikurse është pasqyruar në Modelin e Përbushjes, shpenzimet e administratës tatimore janë më të mëdha kur duhet të përdoren kontaktet një me një për t'u marrë me tatimpaguesit jo të rregullt. Ne ndërtojmë njehin për menaxhimin e rrezikut qe do të kryejë hulumtime duke përdorë metoda ekzistuese dhe ato qe do të zhvillohen për të vendosur programet për parandalimin e delikucencës. Këto programe po ashtu do të mundësojnë intervenim të hershëm kur të jenë identifikuar rreziqet potenciale të përbushjes.</p> <p>Përveç kësaj, do të përmirësojmë metodat tona të adresimit të tatimpaguesit të cilët nuk i kanë dorëzuar me kohë deklaratat tatimore. Sikurse është cekur në komponentin 5, përpunimi i përmirësuar i deklarave do të mundësojë identifikim më të hershëm të tatimpaguesve të cilët nuk kanë dorëzuar deklaratat. Vendosija e një baze të mirë të të dhënave sikurse është përshkruar në komponentin 2 do të na ndihmojë që më me efektivitet të identifikohen ata tatimpagues që janë regjistruar por nuk kanë dorëzuar ndonjë deklarata.</p> <p>Ne po ashtu do të punojmë me institucionet edukative për të ofruar materiale trajnimi për prezantim në shkollat e larta dhe universitete. Ne do të kërkojmë partneritet me institucionet publike përmes së cilës punëtorët e kualifikuar të ATK -së do të shërbejnë si ligjërues mysafir (<i>veçanërisht në Fakultetin Ekonomik</i>) për të mbajtur ligjërata mbi ligjet tatimore, rregullat dhe përbushjen tatimore. Ne besojmë se njohuritë e marra në këtë fazë të edukimit të individit do të ndihmojë të parandalojmë parregullsitë e mëvonshme kur studentët të hyjnë në botën e biznesit.</p>	<p>6.1 Identifikimi i mos-deklaruesve të TVSh- së brenda 20 ditëve pas afatit të dorëzimit të deklarave të TVSh-së dhe caktimi i kontakteve në teren për të përcaktuar pse nuk janë dorëzuar deklaratat dhe vendos afatin brenda së cilit duhet të dorëzohen të gjitha deklaratat delikucente.</p>	<p>Zëvendës Drejtori (Përbushja) Zëvendës Drejtori (TI) Zëvendës Drejtori (operacionet)</p>	<p>Shtator 2010</p>	<p>Nëntor 2010</p>
	<p>6.2 Identifikimi i bizneseve e reja të cilat nuk kanë dorëzuar deklaratat brenda dy muajve pas regjistrimit dhe planifiko vizitë për Edukimin e Tatimpaguesve të përcaktojnë arsyet për mos - dorëzimin e deklarave dhe për të ndihmuar në përgatitjen e ndonjë deklarate që është obligative.</p>	<p>Menaxherët Regjional</p>	<p>Shtator 2010</p>	<p>Vazhdon</p>
	<p>6.3 Vendos proces për administratën tatimore që të sigurojë deklaratat delikucente kur të bëjnë kontakt me tatimpaguesit delikucen për të siguruar se deklaratat delikucente janë dorëzuar siç kërkohet.</p>	<p>Zëvendës Drejtori (Përbushja) Zëvendës Drejtori (Operacionet)</p>	<p>Korrik 2010</p>	<p>Tetor 2010</p>
	<p>6.4 Te ndërtohen procedurat dhe kërkesat që në kontaktet me tatimpaguesit delikucen duhet të përfshihen në përcaktimin e shkakut të delikucencës, veprimet e ndërmarra për të zgjidhur delikucencën dhe informatat për tatimpaguesit se si të shmangët delikucenca në të ardhmen.</p>	<p>Zëvendës Drejtori (Përbushja)</p>	<p>Shtator 2010</p>	<p>Dhjetor 2010</p>
	<p>6.5 Krijimi i Njesisë për menaxhimin e rrezikut për të identifikuar rreziqet e përbushjes për të ardhmen (gjendja politike, ligjet e pritura që do të ndikojnë administratën tatimore, industrinë e reja, përfaqësuesi i tatimpaguesit dhe programet planifikuese tatimore për këshilltare, etj) ashtu që të mund të ndërmerren veprime të hershme për të parandaluar delikucencat.</p>	<p>Zëvendës Drejtori, Përbushja, Drejtori, Modernizimi Menaxheri, Planifikim dhe Analizë</p>	<p>Shtator 2010</p>	<p>Dhjetor 2012</p>
	<p>6.6 Vendosija e marrëdhënieve me institucionet arsimore publike dhe aranzho që punëtorët e kualifikuar të ATK -së të shërbejnë si ligjërues mysafir duke i udhëzuar studentët në ligjet tatimore, rregulloret tatimore dhe kërkesat për të mbetur i rregullt me ligjet tatimore.</p>	<p>Zëvendës Drejtori (Përbushja) Menaxheri, Trajnimet</p>	<p>Mars 2011</p>	<p>Tetor 2012</p>

<p>Në të gjitha kontaktet me tatimpaguesit, qoftë i rregullt apo jo i rregullt, do të shfrytëzojmë kohën e nevojshme për të siguruar se ata e dinë si t'i kryejnë obligimet dhe i kuptojnë pasojat e mos -përbushjes në kërkesat e dorëzimit dhe pagesës së tatimeve. Në rastin e tatimpaguesve jo të rregullt (qoftë ai mos-përbushës në pagesën me kohë apo për nën -</p>	<p>6.7 Aranzhimi i tryezave të rrumbullakëta/seminare të rregullta (tremujore) për bizneset e reja për të informuar bizneset e reja dhe me perspektive për regjistrimin, mbajtjen e shënimeve, dorëzimin e deklaratave dhe kërkesat e për pagesë të bizneseve</p>	<p>Menaxherët Regional</p>	<p>Janar 2011</p>	<p>Shkurt 2011 dhe vazhdon secilin tremujor</p>
<p>raportimin e shumës së vet tatimore) do të identifikojmë shkakun e mos -përbushjes dhe do të edukojmë tatimpaguesin si të bëhet dhe të mbetet i rregullt (përbushës)</p>	<p>6.8 Zhvillimi i prezantimeve vizuale (DVD/CD) që mund t'i ofrohen bizneseve në panairë tregtare dhe vende tjera që përshkruajnë karakteristikat e sistemit tatimor të Kosovës</p>	<p>Zëvendës Drejtori (Përbushja)</p>	<p>Shkurt 2013</p>	<p>Qershor 2013</p>

7. RITJA E EFEKTIVITETIT TË PROGRAMEVE TE KONTROLLIT DHE ANALIZËS SË RREZIKUT DHE IDENTIFIKIMIN E MUNDËSIVE, ME FOKUS NË ATO ÇËSHTJE DHE KONTROLLE QË DO TË KENË NDIKIMIN MË TË MADH NË PËRMBUSHJE DHE DO TË GJENEROJNË SHUMËN MË TË MADHE TË TË HYRAVE

OBJEKTIVI	VEPRIMI	PËRGJEGJËS	FILLON	MBARON
<p>Administrata tatimore ka zhvilluar një model kontrolli që identifikon ata tatimpagues që me gjasë kanë nën -raportuar të ardhurat e tyre tatimore apo kanë nën-paguar obligimet e tyre tatimore. Modeli i kontrollit po ashtu identifikon çështjet që duhet të ekzaminohen gjatë ecurisë së një kontrolli. Duke përdorë modelin e kontrollit, Departamenti i Kontrollit në Zyrat Qendrore do të përzgjedh së paku 90% të të gjitha rasteve që do të kontrollohen në zyrat regionale. Kjo do të na mundësojë që më me efektivitet t'i përdorim burimet tona në kontrollimin e rasteve më produktive. Gjithashtu përzgjedhjen e rasteve do ta bëjë një proces objektiv i lirë nga bazat personale. Kontrollat do të jenë më të fokusuara, duke ulur nevojën për kontrole të plota të librave dhe regjistrimeve të tatimpaguesit.</p> <p>Përderisa presim të ofrojmë një mbulim kontrolli përmes një spektri të gjerë të tatimpaguesve afarist, theksi ynë më i madh do të jetë në ata tatimpagues me qarkullim bruto më të madh se 500,000€. Për të ndihmuar këtë theks, do të ndajmë në segmente popullatën e tatimpaguesve në grupe industriale të gjera dhe mandej do të identifikojmë tatimpaguesit më me rrezik në secilin segment të industrisë.</p> <p>Përmes kontrolleve, do të kërkojmë të identifikojmë karakteristikat e përbashkëta që janë unike për secilën industri që mund të përdoret për publicitet të mëvonshëm dhe fushata të përmbushjes.</p> <p>Modeli i kontrollit ka demonstruar se një numër i madh i tatimpaguesve janë duke raportuar blerje më të mëdha se shitjet e tyre në deklaratat e TVSh-së. Ky trend vazhdon për një periudhë të gjatë kohore dhe ka kontribuar që një numër i madh i tatimpaguesve të bartin tepriçën e TVSh -së dhe të mos paguajnë ndonjë TVSh.</p>	<p>7.1 Sigurimi që të gjithë menaxherët regional, udhëheqësit e ekipeve të kontrolleve dhe inspektorët e kontrollit të marrin trajnimin për përdorimin e modelit të kontrollit, ligjet e reja dhe edukimin e vazhdueshëm profesional vjetor.</p>	<p>Zëvendës Drejtori (Përmbushja) Zëvendës Drejtori (Operacionet) Menaxheri, Trajnimet</p>	<p>Shtator 2010</p> <p>Shtator 2010 (EVP – Edukimi i Vazhdues hëm Profesional)</p>	<p>Dhjetor 2010</p> <p>EVP Vjetor</p>
	<p>7.2 Vendosija dhe zhvillimi i planit të implementimit për arkat fiskale dhe implementimi në një mënyrë të strukturuar për të mundësuar testimin me kohë dhe regjistrimin me kohë të pajisjeve dhe për të siguruar se të dhënat që kërkohen të transmetohen në ATK; siguro se të dhënat e transmetuara të jenë të integruara në modelin e rrezikut të kontrollit dhe të përdoren për qëllime kërkimi dhe përmbushje.</p>	<p>Zëvendës Drejtori (Përmbushja) Drejtor, Modernizimi</p>	<p>Shtator 2010</p>	<p>Dhjetor 2014</p>
	<p>7.3 Vendosija e mundësisë së analizës së rrezikut në Departamentin e Kontrollit të Zyrës Qendrore për të freskuar Modelin e Kontrollit, identifikojmë informatat tjera të palëve të treta që do të ishin të dobishme, identifikojmë ata tatimpagues me rrezik më të lartë dhe përcakto fushëveprimin dhe intensitetin e kontrollit</p>	<p>Zëvendës Drejtori (Përmbushja) Menaxheri, Kontrolli</p>	<p>Korrik 2010</p>	<p>Janar 2011 Vazhdon</p>

<p>Nuk është e logjikshme se një tatimpagues të ishte në gjendje të mbijetojë gjatë në biznes kur blerjet dhe importet e tij vazhdimisht janë më të mëdha se shitjet e tija. Ne do t'i vëmë në shënjestër ato kompani që kanë qenë në pozitë kreditore për një periudhë të zgjatur me blerje dhe importe që tejkalojnë shitjet e kontrollit. Kjo gjendje ndikon në masë të madhe në TVSh, por gjithashtu rezulton që kompanitë e mëdha të mos paguajnë shumën e duhur të tatimit në të ardhura.</p>	<p>7.4 Centralizimi i përzgjedhjes se rasteve për kontroll në Zyrën Qendrore, bazuar në analizat e faktorëve të rrezikut për kontroll, duke ofruar mbulim të caktuar në spektrin e bizneseve, me theksim të madh në bizneset me qarkullim prej 500,000 € e më shumë – identifikoj rreziqet dhe çështjet që do të kontrollohen para se rasti të jetë bartur në terren; tatimpaguesit në gjendje kreditore të vazhdueshme të TVSh -së me blerje dhe importe më të mëdha se shitjet po ashtu do të jenë në shënjestër për kontroll.</p>	<p>Zëvendës Drejtori (Përbushja)</p>	<p>Shtator 2010</p>	<p>Mars 2011 (100% i centralizuar)</p>
<p>Rezultatet e programit të kualitetit të kontrollit do të identifikojnë fushat me potencial në të cilat janë të nevojshme përmirësimet e procesit. Ne do të sigurojmë se të gjithë inspektorët e kontrollit janë të trajnuar në aplikimin e ligjit dhe teknikave të kontrollit. Gjithashtu do të bëjmë programet vjetore të trajnimit për edukim të vazhdueshëm profesional. Do të ofrojmë vegla të automatizuara të nevojshme për inspektorët e kontrollit, përfshirë kompjuterët laptop, për të ndihmuar procesin e tyre të kontrollit dhe për të shkurtuar kohën e nevojshme për të përfunduar një kontroll.</p>	<p>7.5 Përgatitja e Doracakut të rimbursimit të TVSh -së dhe siguro se menaxherët, udhëheqësit e ekipeve dhe inspektorët e kontrollit janë të trajnuar në procedurat e rimbursimit për TVSh dhe përdorimi i modelit të kontrollit në identifikimin e faturave apo entiteteve të mundshme fiktive.</p>	<p>Menaxheri, Kontrolli</p>	<p>Shtator 2010</p>	<p>Dhjetor 2010</p>
<p>Çdo sisteme i mirë i përzgjedhjes së kontrollit në bazë të rrezikut është po aq i efektshëm sa informatat që janë të futura në të. Sikurse është cekur në Strategjinë Pesë, vendimet mbi rastet shpesh kanë ndikuar keq nga mungesa e të dhënave apo deklaratave. Ne do të përpiqemi të sigurojmë se vlerësimet tonë të rrezikut janë bërë mbi të dhënat e mira dhe pasqyrojnë gjendjen e vërtetë.</p>	<p>7.6 Publikimi i kërkesave të reja të rimbursimit për TVSh ashtu që tatimpaguesit të dinë cilat dokumente kërkohen për një kërkesë të suksesshme</p>	<p>Menaxheri, Kontrolli Menaxheri, Edukimi i Tatimpaguesve</p>	<p>Shtator 2010</p>	<p>Dhjetor 2010</p>
<p>Për të përmirësuar procesin e vlerësimit të rrezikut, do të vazhdojmë të rishikojmë dhe freskojmë sistemin tonë me mundësi të reja. Informatat nga kontrollet e kryera do të kapen dhe përfshihen në të dhënat e analizuara në procesin e vlerësimit të rrezikut.</p>	<p>7.7 Përcillja e rezultateve matëse të kualitetit të kontrollit sipas regjioneve për të identifikuar nevojat e trajnimit për secilin staf regjional</p>	<p>Menaxheri, Kontrolli</p>	<p>Shtator 2010</p>	<p>Vazhdon</p>
<p>Çdo sisteme i mirë i përzgjedhjes së kontrollit në bazë të rrezikut është po aq i efektshëm sa informatat që janë të futura në të. Sikurse është cekur në Strategjinë Pesë, vendimet mbi rastet shpesh kanë ndikuar keq nga mungesa e të dhënave apo deklaratave. Ne do të përpiqemi të sigurojmë se vlerësimet tonë të rrezikut janë bërë mbi të dhënat e mira dhe pasqyrojnë gjendjen e vërtetë.</p>	<p>7.8 Duke përdorë teknologjinë e tanishme në dispozicion, automatizimi i procesit të kontrollit deri në masën e mundshme për të ofruar përcjellje të rastit; raportim të kohës; eliminim të përgatitjes manuale të dokumenteve, dhënia e mostrave të formularëve për shumicën e dokumenteve përfshirë raportet e kontrollit; dhe të sigurohet që rezultatet e kontrollit përcillen për përdorim në referimet e mëvonshme të modelit të kontrollit dhe për të përcaktuar përqindjen e vlerësimeve të kontrollit që në të vërtetë janë inkasuar.</p>	<p>Drejtori i Modernizimit Zëvendës Drejtori (Operacionet) Menaxheri, Kontrolli</p>	<p>Korrik 2010</p>	<p>Dhjetor 2010</p>

<p>Analistët në departamentin e kontrollit do të kryejnë kërkime për të identifikuar fushat potenciale të mos - përbushjes dhe për të zhvilluar strategji për adresimin e rreziqeve të reja dhe ekzistuese të përbushjes. Gjithashtu do të zgjerojmë të dhënat e jashtme që janë në dispozicion për të plotësuar modelin tonë të kontrollit ashtu që formulat e tij të jenë më të sakta dhe të ofrojnë një pasqyrë shumë më komplete të tatimpaguesit i cili është analizuar.</p>	<p>7.9 Analizimi i rezultateve të kontrollit për të siguruar se rezultatet e pritura janë realizuar dhe për të përcaktuar nëse ekziston nevoja për të bërë rregullime në modelin e kontrollit</p>	<p>Menaxheri, Kontrolli</p>	<p>Tetor 2010</p>	<p>Vazhdon</p>
